



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 39, datë 30/07/2004

**“PËR
DHËNIE STIMULI NXËNËSVE ME REZULTATE TË SHKËLQYERA NË
SHKOLLAT PUBLIKE TË QYTETIT TË TIRANËS”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës në mbledhjen e tij të datës 30/07/2004, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, për financimin e projektit “Dhënie stimuli nxënësve me rezultate të shkëlqyera në shkollat publike të qytetit të Tiranës”, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 11, pika 3/a, neni 72, pika 1/c, neni 10, pika 3 (paragrafi II/c), dhe neni 32, gërma “m”, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 “Për buxhetin lokal” ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.7776, dt.22/12/1993 “Për buxhetin lokal”, ligjit Nr.7952, dt.21/06/1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, neni 2, në dispozitat normative “Për arsimin parauniversitar” të vitit 2002, neni 38 pika 1/f dhe 1/g, në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, neni 6, neni 27, neni 28, neni 29, në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të viti 2003 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2004”, dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I;

1. Të miratojë “Dhënie stimuli nxënësve me rezultate të shkëlqyera në shkollat publike të qytetit të Tiranës”.
2. Të miratojë këto kritere për përfitimin e stimullit:
 - Nxënës që mbarojnë vitin mësimor paraardhës me të gjitha dhjeta
 - Nxënës që vazhdojnë klasën e V-të, VI-të, VII-të dhe VIII-të në shkollat 8-vjeçare publike dhe nxënës që frekuentojnë vitin e I-rë, II-të, III-të dhe IV-të në shkollat e mesme të përgjithshme publike.
3. Dhënia e stimullit të bëhet sipas dokumentacionit të mëposhtëm:
 - Fotokopje e noterizuar e dëftesës së vitit shkollor
 - Vërtetim nga Drejtoria e Shkollës për vazhdimin e vitit shkollor
 - Çertifikatë personale e kohëve të fundit me fotografi
 - Çertifikatë familjare.

4. Lista e nxënësve me dhjeta e dërguar nga Drejtoritë e Shkollave miratohet nga Drejtoria Arsimore e Tiranës.
5. Stimuli për një nxënës të shkollës 8-vjeçare të jetë 3000 lekë në muaj dhe për një nxënës të shkollës së mesme të jetë 5000 lekë në muaj për vitin mësimor.
6. Efektet financiare të këtij vendimi do të përfshihen në çdo vit buxhetor.
7. Efektet financiare për vitin 2004 të përballohen duke pakësuar buxhetin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës, në zërin “Projekte sociale”, në shumën 12.812.000 lekë. Kjo shumë t’i shtohet buxhetit të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve në artikullin 602 me destinacion për financimin e “Dhënie stimuli nxënësve me rezultate të shkëlqyera në shkollat publike të qytetit të Tiranës”.
8. Për zbatimin e këtij vendimi të nxirren udhëzimet përkatëse për organizimin dhe mënyrën e pagesës.
9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI